



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave

Raporti i zbatimit të planit të punës së Ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal

Janar - Dhjetor 2024

Prishtinë, Janar 2025

Ky raport paraqet punën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL për periudhën *Janar – Dhjetor 2024*.

Raporti përshkruan aktivitetet e të gjitha njësive organizative të MAPL-së duke u fokusuar në katër fusha kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së ministrisë sipas planit vjetor të punës për vitin 2024.

Raporti është hartuar nga Divizioni për Koordinim të Politikave.

Saktësia e të dhënave është përgjegjësi e departamenteve dhe njësive organizative të MAPL-së.

Përmbajtja

Shkurtesat.....	3
Hyrje.....	4
I. Kritja e zhvillimit ekonomik lokal përmes mbështetjes financiare të komunave të bazuar në performancë ...	5
1.1.Zhvillimi i kuadrit strategjik për zhvillim ekonomik lokal.....	5
1.2.Financimi i projekteve të komunave.....	5
1.3. Vlerësimi i performancës komunale	6
II. Avancimi i bashkëpunimit ndërkomunal, komunal ndërkombëtar dhe ndërkufitar	7
2.1. Bashkëpunimi ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar.....	7
2.2. Zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar	7
III. Avancimi i politikave dhe i kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale.....	10
3.1. Zhvillimi i akteve ligjore dhe nënligjore.....	11
3.2. Vlerësimi i ndikimit të politikave në fushën e vetëqeverisjes lokale	11
3.3. Monitorimi i kuvendeve të komunave.....	11
3.4. Adresimi i obligimeve nga agenda evropiane	12
3.5. Koordinimi i politikave.....	13
IV. Ngritja e transparencës komunale, promovimi i të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i kapaciteteve	13
4.1. Aktivitetet në fushën e të drejtave të njeriut dhe transparencën komunale	14
4.3. Zhvillimi i platformës shtetërore E-KOMUNAT.....	16
4.4. Informimi i publikut për aktivitetet e MAPL-së.....	17
4.6. Bashkëpunimi me shoqërinë civile.....	17
4.7. Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal.....	18
V. Administrata, financat, auditimi dhe prokurimi.....	18
5.1. Administrata dhe financat.....	18
5.2. Auditimi i Brendshëm	20
5.3. Prokurimi	20

Shkurtesat

AE	Agjenda Evropiane
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
BB	Banka Botërore
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative
ECDC	Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
IE	Integrimet Evropiane
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IKSHIP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MFT	Ministria e Financave dhe Transfere
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MSA	Marrëveshja për Stabilizim Asociim
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PL	Pushteti Lokal
PKZMSA	Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
PQ	Pushteti Qendror
QOMPBAIP	Qendra Operative e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
QPKS	Qendra për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
QOE	Qendra Operative Emergjente
QPKS	Qendra për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve
SDC/DEMOS	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SIDA	Agjensioni Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar
SMFK	Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale
SVL	Strategjia për Vetëqeverisje Lokale
SHE	Shtabet Emergjente
SZHEL	Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID	Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik

Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në përputhje me mandatin e saj ligjor, objektivat e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016–2026, si dhe Planin Vjetor të Punës për vitin 2024, ka realizuar aktivitetet e planifikuara për periudhën Janar – Dhjetor 2024. Raporti pasqyron arritjet sipas fushave të përcaktuara në këtë plan, të integruara edhe në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim. Aktivitetet e raportuara zënë vend në kuadër të pesë objektivat kryesore të punës, si vijon:

- Rritja e zhvillimit ekonomik lokal përmes mbështetjes financiare të komunave të bazuar në performancë;
- Avancimi i bashkëpunimit ndërkomunal, komunal ndërkombëtar dhe ndërkufitar;
- Avancimi i politikave dhe i kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale;
- Ngritja e transparencës komunale, promovimi i të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i kapaciteteve
- Administrata dhe financat, auditimi dhe prokurimi.

Raporti bazohet në të dhënat e raportuara për aktivitetet e realizuara nga departamentet dhe njësitë/divizionet e MAPL-së, respektivisht:

- Departamentit për Zhvillim të Qëndrueshëm Komunal;
- Departamentit për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe Ndërkufitar;
- Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave;
- Departamentit Ligjor dhe për Monitorim të Komunave;
- Departamentit për Performancë dhe Transparencë në Komuna;
- Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizioni për Komunikim me Publikun;
- Divizioni i Auditimit të Brendshëm;
- Divizioni i Prokurimit.

Lidhur me metodologjinë e raportit, janë marrë për bazë informatat nga njësitë përkatëse të MAPL-së, të cilat janë analizuar dhe janë vendosur sipas objektiveve dhe aktiviteteve të caktuara në planin vjetor të punës. Raporti merr për bazë indikatorët sasior dhe cilësor për aktivitetet realizuara për periudhën Janar-Dhjetor 2024.

I. Rritja e zhvillimit ekonomik lokal përmes mbështetjes financiare të komunave të bazuar në performancë

Aktivitetet e realizuara në kuadër të objektivit të parë, janë grupuar në 3 fusha kryesore si vijon:

- Hartimit të politikave për zhvillim ekonomik lokal;
- Financimit të projekteve të komunave;
- Menaxhimi i performancës komunale;

1.1. Zhvillimi i kuadrit strategjik për zhvillim ekonomik lokal

Zhvillimi ekonomik lokal është një proces që ka për qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve, duke nxitur rritjen e investimeve, stimuluar ndërmarrjet me potencial zhvillimi, promovuar krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe duke ngritur infrastrukturën e nevojshme për ta lehtësuar bashkëpunimin midis palëve. Lidhur me këtë Qeveria e Kosovës, nën udhëheqjen e MAPL-së dhe në bashkëpunim me institucionet tjera të linjës, komunat dhe akterët tjerë relevantë ka hartuar Planin Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030, me qëllim të lokalizojë orientimet strategjike që dalin nga SKZH dhe PKZH 2030 dhe strategjitë sektoriale që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik. Ndërsa për zbatimin e Programit Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2023-2029, është krijuar komiteti zbatues i PNZHEL si dhe është mbajtur takimi i parë i komitetit, me ç' rast është përgatitur edhe lista e përgjegjësive të institucioneve bartëse për zbatimin e masave të përcaktuara. Lidhur me këtë është realizuar takimi edhe me drejtorët komunal për zhvillim ekonomik lokal lidhur me obligimet e dala nga PNZHEL.

Për mbështetjen e komunave në procese buxhetore, është përgatitur shkresa për Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve me rekomandimet në procesin e përcaktimit të financimit komunal nga Komisioni i Granteve sipas LFPL dhe LMFP.

- Është hartuar raporti i shpenzimeve të komunave për vitin 2023;
- Është hartuar raporti i të hyrave vetanake të komunave për vitin 2023;
- Është hartuar raporti vjetor përmbledhës i investimeve kapitale për projekte për vitin 2023;

1.2. Financimi i projekteve të komunave

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuadër të investimeve kapitale ka tri programe:

- Programet për financimin e projekteve kapitale të komunave
- Programi për mbështetje për projektet infrastrukturore për komunitete
- Bashkëfinancimi me donatorë për skemën e granteve bazuar në performancë komunale

Programet për financimin e projekteve kapitale të komunave janë një ndër instrumentet kryesore të mbështetjes direkte të komunave në fushën e zhvillimit ekonomik. Për këtë program MAPL ka përgatitur kriteret për financim të projekteve të komunave në fushën e bashkëpunimit ndërkomunal dhe janë dërguar tek menaxhmenti i lartë. Është lansuar fondi për financim të projekteve më datë 30.01.2024 dhe në kuadër të kësaj thirrjeje janë pranuar

aplikimet nga 7 komuna me 9 projekte të cilat janë vlerësuar nga komisioni, është hartuar raporti, si dhe është bërë njoftimi i përfituesve. Për procesin e aplikimit dhe përgatitjen e projekteve për bashkëfinancim me MAPL, është realizuar punësoria me drejtoret komunal. Poashtu marrëveshja për financimin e projektit është nënshkruar me komunën e Obiliqit dhe në kuadër të kësaj çështjeje është mbajtur punësoria me menaxheret e projekteve lidhur me implementimin e projekteve, janë realizuar takime teknike me komunën e Obiliqit, për projektin e financuar nga MAPL, si dhe janë realizuar vizitat në terren për verifikimin e progresit të punimeve.

Për programin për mbështetje për projektet infrastrukturore për komunitete, MAPL ka përgatitur kriteret për financim të projekteve të komunave në fushën e bashkëpunimit ndërkomunal dhe janë dërguar tek menaxhmenti i lartë për aprovim. Lansimi i fondit për financim të projekteve për fazën e parë është bërë me datë 30.01.2024, ndërsa për fazën e dytë është bërë me datë 08.08.2024. Në kuadër të këtyre thirrjeve janë pranuar aplikimet nga komunat, të cilat janë vlerësuar nga komisioni, është hartuar raporti si dhe është bërë njoftimi i përfituesve për të dy fazat. Edhe për këtë program për procesin e aplikimit dhe përgatitjen e projekteve për bashkëfinancim me MAPL është realizuar punësoria me drejtoret komunal lidhur me implementimin e projekteve. Poashtu marrëveshjet për financimin e projekteve janë nënshkruar me gjithsej 12 komuna dhe në kuadër të kësaj çështjeje janë realizuar takime teknike me komunat përfituese për projektet e financuar nga MAPL, si dhe janë realizuar vizitat në terren për verifikimin e progresit të punimeve.

Në kuadër të bashkëfinancimit me donatorë për skemën e granteve bazuar në performancën komunale, është koordinuar procesi i projekteve me komunat përfituese lidhur me projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale për fondet e MAPL-se, si dhe është dërguar lënda e kompletuar me 33 projekte në MFPT për opinion financiar dhe është pranuar opinionin pozitiv nga MFPT. Ndërsa marrja e vendimit të Qeverisë për rialokimin e mjeteve është bërë më dt.12.05.2024. Zotimi për ndarjen e mjeteve financiare është përgatitur.

Është përgatitur informata lidhur me financimin e projekteve për palët e treta - qasje në dokumente publike si dhe është dërguar raporti i progresit të projekteve tek menaxhmenti. Është përfunduar *Raporti vjetor përmbledhës i investimeve kapitale për projekte për vitin 2023, Raporti përmbledhës i investimeve kapitale (2008 - 2023) i investimeve kapitale dhe Raporti i tri viteve të fundit (2021 - 2023) i investimeve kapitale.*

1.3. Vlerësimi i performancës komunale

Rëndësi e madhe i është kushtuar edhe avancimit të sistemit të performancës komunale dhe skemës së grantit të bazuar në performancë. Sa i përket matjes së performancës së komunave për periudhën Janar-Dhjetor 2024, me 15 Shkurt 2024 është hapur thirrja për raportim të performancës komunale për vitin 2023. Të gjitha komunat janë njoftuar lidhur me procesin e raportimit të performancës komunale 2023. Janë standardizuar procedurat e verifikimit për vlerësimin e performancës komunale për periudhën Janar-Dhjetor 2023. Është bërë pranimi dhe vlerësimi paraprak i të dhënave nga sistemi i SMPK, si dhe është trajtuar procesi i verifikimit paraprak në SMPK duke eliminuar gabimet eventuale teknike/logjike. Është përfunduar faza e përpunimit dhe verifikimit të të dhënave dhe poashtu është përgatitur dhe publikuar raporti final i performancës komunale për vitin 2023.

Gjatë kësaj periudhe është hartuar, miratuar dhe publikuar Raporti i Grantit të Performancës Komunale për vitin fiskal 2025, bazuar në performancën e vitit 2023, ku nga 38 komunat e vlerësuara 12 komuna (Dragash, Glogoc, Istog, Junik, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Mamushë, Mitrovicë Jugore, Partesh, Prizren dhe Suharekë) apo 32% kanë përmbushur kushtet minimale dhe janë komuna përfituese të këtij granti, i cili ka vlerën 7,8 milion euro dhe bashkë-financohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Bashkimi Evropian, Zvicra dhe Suedia. Poashtu është hartuar marrëveshja me donatorë për fondet e Grantit për Performancë Komunale.

Është hartuar analiza e kushteve minimale për performancën e vitit 2024 dhe janë publikuar Rregullat e Grantit të Performancës Komunale për vitin 2026. Poashtu është mbajtur takimi me koordinatorët e performancës, për performancën e vitit 2024, për grantin e vitit 2026.

Gjatë kësaj periudhe është hartuar metodologjia për auditim social të GPK-së, gjatë fazës fillestare, ku janë trajnuar organizatat e shoqërisë civile me qëllim të rritjes së kapaciteteve të tyre, për të kuptuar më mirë procesin e qeverisjes lokale në Kosovë, si dhe përvetësimin e procesit të auditimit social në komuna. Auditimi Social është realizuar në Komunitet: Glllogoc, Skenderaj, Viti, Shtime, Ranillug, Kaçanik.

II. Avancimi i bashkëpunimit ndërkomunal, komunal ndërkombëtar dhe ndërkufitar

Aktivitetet në këtë objektiv janë realizuar në drejtim të:

- Forcimit të bashkëpunimit ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar;
- Zbatimit të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar;

2.1. Bashkëpunimi ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka vazhduar aktivitetet lidhur me mbështetjen e komunave për bashkëpunim ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar për vitin 2024, për çka ka mbajtur 4 takime me donatorë për mbështetje të aktiviteteve. Në kuadër të ***bashkëpunimit ndërkomunal***, gjatë kësaj periudhe janë realizuar 7 vizita në komuna rreth nxitjes dhe promovimit të bashkëpunimit ndërkomunal, janë pranuar 4 iniciativa/nisma për bashkëpunim ndërkomunal, është nënshkruar një (1) Marrëveshje e Bashkëpunimit Ndërkomunal, janë përgatitur *Raportet për Iniciativat dhe Marrëveshjet e Bashkëpunimit Ndërkomunal për Komunitet e Republikës së Kosovës* dhe janë vlerësuar 3 Vendime të ligjshmërisë së nismave dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkomunal. Poashtu është mbajtur punësoria dy ditore për zyrtarët komunal lidhur me menaxhimin e ciklit të projektit në kontekst të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndër-komunal.

Sa i përket ***bashkëpunimit komunal ndërkombëtar***, gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjithsejtë gjashtë (6) iniciativa/nisma për bashkëpunim ndërkombëtar ndërsa nuk është arritur asnjë marrëveshje e bashkëpunimit, është përgatitur *Raporti vjetor për Iniciativat dhe Marrëveshjet e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar për Komunitet e Republikës së Kosovës* dhe janë vlerësuar 3 vendime të ligjshmërisë së Nismave dhe Marrëveshjeve për bashkëpunim komunal ndërkombëtar.

Janë realizuar 5 takime me misionet diplomatike të akredituara në Kosovë dhe 5 takime me misionet diplomatike të akredituara jashtë vendit, me qëllim të koordinimit sa më të mirë të aktiviteteve në fushën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar.

2.2. Zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar

Ka vazhduar avancimi i bashkëpunimit ndërkufitar në kuadër të tri programeve: Shqipëri – Kosovë, Kosovë – Maqedoni e Veriut dhe Mali i Zi – Kosovë.

Në kuadër të programit të BNK IPA II Shqipëri – Kosovë, janë realizuar **10** vizita monitoruese tek projektet e kontraktuara në kuadër të thirrjes së tretë dhe të katërt të IPA II, si në vijim:

- Projekti "BioDrini" në Rahovec;

- Projekti “Eco - Tourism Routes in the Cross-Border Area for the Promotion of Alternative Tourism (ECO-ROUTES)” në Kukës;
- Projekti “Bridging Tourism through Cultural Heritage and Smart Solutions in Lezha and Gjakova” në Kukës dhe Tiranë;
- Projekti “Pathway towards an efficient use of local natural resources” në Kurbin;
- Projekti "Mirdita Unik" në Junik;
- Projekti “EFFORT” në Mirditë.

Në kuadër të programit BNK IPA II Mali i Zi – Kosovë, janë realizuar **11** vizita monitoruese tek projektet e financuara në kuadër të Thirrjes së tretë të IPA II, si në vijim:

- Projekti "Skills for Sustainable Employment in the Cross-Border Region of Montenegro and the Republic of Kosovo – No Borders!";
- Projekti “Young NEETs: new opportunities for work and increased employability – UNEETED”
- “In Employment, Education, Training – IN EET”;
- “New Environment Revitalization Approach – NERA”;
- “Cross-border Green Deal”;
- “Culture heritage – Act SMART, save water”;
- “The Cultural Renaissance from Skadar Lake to Kosovo – TIME TRAVEL”;
- “C.L.O.S.E.R. – Culture-Led Opportunities for Sustainable Economic Revitalisation”;
- “Turning our villages into tourism destinations”;
- “Evocation and Attraction of Cultural Heritage – Christian Antiquity and Turkish Bath for Cultural Tourism”;
- “Tourism for the Future”

Në kuadër të programit BNK IPA II Kosovë – Maqedoni e Veriut, janë realizuar 6 vizita monitoruese tek projektet e kontraktuara në kuadër të thirrjes së pestë të IPA II, si në vijim:

- “Pilot interventions for wastewater treatment and solid waste management in the cross-border region”
- “ Reviving crafts and building culture for joint touristic development”

Menaxhimi i Kontratës së Grantit për Asistencë Teknike në kuadër të tri programeve të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë, Shqipëri – Kosovë dhe Kosovë – Maqedoni e Veriut

Programi IPA III Shqipëri- Kosovë - Në kuadër të këtij programi janë përfunduar aktivitetet si:

- Raporti Vjetor i Zbatimit (AIR) të programit të BNK-së për vitin 2023 i cili është miratuar nga Komitetet e Përbashkëta Monitoruese;
- Plani Vjetor i Punës (AWP);
- Plani i Komunikimit dhe Vizibilitetit (C&VP), i cili është miratuar nga JMC;
- Janë mbajtur 2 takime bilaterale në mes të Strukturave Operative të programit;
- Është mbajtur forumi i 10-të regional i BNK-së në Budva (Mali i Zi), organizuar nga CBIB+;
- Janë mbajtur tri trajnime për stafin e BNK-së: *trajnimi për verifikimin e kostove, trajnimi për vlerësimin e projekteve, dhe trajnimi për rregullat e PRAG.*

Programi IPA III Kosovë-Maqedoni e Veriut - Në kuadër të këtij programi janë përfunduar aktivitetet si:

- Raporti vjetor (AIR) për zbatim të programit të BNK-së për vitin paraprak i cili është miratuar nga Komitetet e Përbashkëta Monitoruese;

- Plan i vjetor i Komunikimit dhe Vizibilitetit i cili është miratuar nga JMC;
- Është mbajtur një takim bilateral në mes të Strukturave Operative të programit;

Programi IPA III Mali i Zi- Kosovë Në kuadër të këtij programi janë përfunduar aktivitetet si:

- Raporti vjetor (AIR) për zbatim të programit të BNK-së për vitin paraprak i cili është miratuar nga Komitetet e Përbashkëta Monitoruese;
- Plan i vjetor i Komunikimit dhe Vizibilitetit i cili është miratuar nga JMC;
- Hartimi i 12 raporteve mujore për zbatimin e TAGC;
- Përgatitja e deklaratave vjetore, vetëpyetësorit dhe listës kontrolluese që garanton zbatimin efikas të programit të BNK-së Mali i Zi – Kosovë dhe dërgimi tek struktura e BNK-së në Mal të Zi;
- Përgatitja e dy raporteve lidhur me menaxhimin e rrezikut në kuadër të zbatimit të programit të BNK-së Mali i Zi – Kosovë;

Menaxhimi i thirrjeve për propozime në kuadër të tri programeve të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë, Shqipëri – Kosovë dhe Kosovë – Maqedoni e Veriut

- ✓ **Programi IPA III Shqipëri-Kosovë** - për këtë objektiv nuk është zhvilluar ndonjë aktivitet.
- ✓ **Programi IPA III Kosovë-Maqedoni e Veriut** - Në kuadër të këtij programi është shpallur thirrja e parë për projekt propozime, ku në kuadër të kësaj thirrjeje janë organizuar 2 sesione informative dhe 2 sesione për gjetjen e partnerëve. Shuma totale e thirrjes është 3,240,00.00 euro, ndërsa prioritetet tematike të thirrjes janë: *Mbrojtja e ambientit, adaptimi dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezeqeve dhe Konkurrueshmëria, mjedisi i biznesit, dhe zhvillimi i MSME-ve, tregtisë dhe investimeve.*
- ✓ **Programi IPA III Kosovë-Mali i Zi-** Në kuadër të këtij programi është shpallur thirrja e parë për Projekt Propozime (CfP). Shuma totale e thirrjes është 5,400,000.00 euro, ndërsa prioritetet tematike të thirrjes janë: *Rritja e punësimit të rinjve dhe personave të marginalizuara në rajonin ndërkufitar dhe Nxjitja e turizmit të qëndrueshëm në rajonin ndërkufitar.*

Ngritja e kapaciteteve për përfituesit e projekteve në kuadër të tri programeve të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë, Shqipëri – Kosovë dhe Kosovë – Maqedoni e Veriut

- ✓ **Programi IPA III Shqipëri - Kosovë** për këtë objektiv nuk është zhvilluar ndonjë aktivitet.
- ✓ **Programi IPA III Kosovë-Maqedoni e Veriut** - Në kuadër të programit është mbajtur:
 - 1 trajnim për përfituesit e thirrjes së 5-të në kuadër të IPA II (procedurat e prokurimit sekondar PRAG 2021.1)
 - 1 trajnim për menaxhimin e ciklit të projektit,
 - 4 trajnime për përgatitjen e projekt propozimeve për autoritetet lokale (dhe rajonale);
 - 2 sesione informative;
 - 2 sesione për gjetjen e partnerëve;
- ✓ **Programi IPA III Kosovë-Mali i Zi -** Në kuadër të programit:
 - Është finalizuar pakoja aplikuese për hapjen e thirrjes së parë për projekt propozime; si dhe
 - Janë mbajtur 2 trajnime PCM.

Aplikacioni për TAGC-në e re është dërguar i kompletuar për miratim tek Delegacioni i BE-së në Mal të Zi më 26 shkurt 2024. Aplikacioni është miratuar dhe TAGC e re ka filluar zbatimin nga data 04 prill 2024 dhe përfundon më 04 prill 2026.

2.3. Kontrolli i programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar

Për kontrollin dhe verifikimin financiar të fondeve të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, në përputhje me rregullat dhe standardet e BE-së dhe ligjet e aplikueshme vendore është përgatitur dhe aprovuar plani vjetor

i vizitave *on the spot check*, dhe e njëjta është ndarë me Drejtorinë për Financa dhe Kontraktim të Fondeve të BE-së në Ministrinë e Financave të Malit të Zi – CFCU.

Janë pranuar të gjitha (11) kontratat e përfituesve nga thirrja e III (tretë) për propozime.

Është dërguar Letra konfirmuese për Autoritetin Kontraktues lidhur me shpenzimet e pranueshme dhe jo të pranueshme nga përfituesit për 16 kontratat si me poshtë: CFCU/MNE/148“PRAXIS”, CFCU/MNE/149“CARES 2- Cross-border Actions in the Reproductive Health Sector 2”, CFCU/MNE/151“Transhumance - new tourism offer of Kosovo and Montenegro”, CFCU/MNE/150“Tourism hubs for better tourism offer in less advantaged mountainous areas”, CFCU/MNE/147“Creating Employment in Agriculture”, CFCU/MNE/231“Turning our villages into tourism destination”, CFCU/MNE/230“C.L.O.S.E.R. — Culture-Led Opportunities for Sustainable Economic Revitalization”, CFCU/MNE/224“New Environment Revitalization Approach - Nera”, CFCU/MNE/228“Cross - border Green Deal”, CFCU/MNE/232“In Employment, Education, Training - IN EET”, CFCU/MNE/223“Act SMART, save water”, CFCU/MNE/229“Evocation and Attraction of Cultural Heritage — Christian Antiquity and Turkish Bath for Cultural Tourism”, CFCU/MNE/227“‘The Cultural renaissance from Skadar Lake to Kosovo-Time Travel”, CFCU/MNE/225“‘Young NEET new opportunities for work and increased employability - UNEETED”, CFCU/MNE/226“Skills for Sustainable Employment Employment in the Cross-Border Region of Montenegro and the Republic of Kosovo — No Borders”, CFCU/MNE/234“Tourism for future”.

Gjithashtu janë finalizuar dhe janë dërguar në CFCU garancioni vjetor Menaxhues dhe vetëpyetëtori me dokumentet të tjera shoqëruese për vitin 2024.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 2 vizita në terren tek projektet e thirrjes së dytë: CFCU/MNE/147“Creating Employment in Agriculture”dhe CFCU/MNE/150“Tourism hubs for better tourism offer in less advantaged mountainous areas”, si dhe janë realizuar 11 vizita në terren tek projektet e thirrjes së tretë: CFCU/MNE/231“Turning our villages into tourism destination”, CFCU/MNE/230“C.L.O.S.E.R. — Culture-Led Opportunities for Sustainable Economic Revitalization”, CFCU/MNE/224“New Environment Revitalization Approach - Nera”, CFCU/MNE/228“Cross - border Green Deal”, CFCU/MNE/232“In Employment, Education, Training - IN EET”, CFCU/MNE/223“Act SMART, save water”, CFCU/MNE/229“Evocation and Attraction of Cultural Heritage — Christian Antiquity and Turkish Bath for Cultural Tourism”, CFCU/MNE/227“‘The Cultural renaissance from Skadar Lake to Kosovo-Time Travel”, CFCU/MNE/225“‘Young NEET new opportunities for work and increased employability - UNEETED”, CFCU/MNE/226“Skills for Sustainable Employment Employment in the Cross-Border Region of Montenegro and the Republic of Kosovo — No Borders”, CFCU/MNE/234“Tourism for future”.

Poashtu janë përcjellur në CFCU Anekset për menaxhimin e riskut siç janë të parapara me dokumentin e programit PLCP: Risk Alert Form, Risk Action Plan, Risk Register.

III. Avancimi i politikave dhe i kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe që ndërlidhen me përmbushjen e objektivit 2 të Planit të Punës për vitin 2024, janë shtrirë në drejtim të:

- Hartimit të projektligjeve dhe akteve nënligjore të planifikuara;
- Konsultimit paraprak të akteve sektoriale;
- Takimeve të rregullta me komunat;
- Monitorimit të komunave;

- Adresimin dhe zbatimin e obligimeve nga agenda evropiane;
- Koordinimit të politikave;
- Raporteve të hartuara.

3.1. Zhvillimi i akteve ligjore dhe nënligjore

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, fokus të veçantë i ka dhënë edhe zhvillimit dhe avancimit të legjislacionit sipas programit legjislativ për vitin 2024 dhe dokumenteve tjera, të cilat janë në proces të hartimit dhe plotësim/ndryshimit, si në vijim:

- Vlerësimi Ex -Post i Ligjit për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtina – është larguar nga plani legjislativ i MAPL-së për vitin 2024;
- Udhëzimi Administrativ për zbatimin e ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale – hartimi i këtij Udhëzimi Administrativ fillon atëherë kur të miratohet Ligji i për Dhënin në Shfrytëzim të Pronës Komunale në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Udhëzimi Administrativ për zbatimin e ligjit për shqyrtimin Administrativ të Akteve Komunale – hartimi i këtij Udhëzimi Administrativ është bartur në vitin 2025, pasi që Ligji për Shqyrtimin Administrativ të Akteve Komunale është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në muajin Dhjetor të vitit 2024;
- Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. Xx/2024 për Ofrimin e Hapësirave në Objekte të Komunës për Institucionet Qendrore që ofrojnë Shërbime në Komunë – është hartuar dhe është dërguar në Kabinetin e Ministrisë;
- Doracaku për përgjegjësit e komunave që derivojnë nga aktet ligjore të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministrit sektorial, është hartuar;
- **Manuali shpjegues për kriteret dhe procedurat e realizimit të buxhetimit me pjesëmarrje.**

3.2. Vlerësimi i ndikimit të politikave në fushën e vetëqeverisjes lokale

Sa i përket konsultimit paraprak të akteve të ministrive sektoriale dhe përputhshmërisë së tyre me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, është themeluar Grupi Punues brenda ministrisë i cili është përgjegjës për shqyrtimin e akteve për konsultim paraprak, i cili në vazhdimësi pranon akte nga ministrinë e linjës për konsultim paraprak. Për periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë pranuar dhe shqyrtuar 5 kërkesa për konsultim paraprak. Ndërsa, lidhur me shkresat njoftuese që adresohen në komuna, në këtë periudhë kohore janë pranuar dhe shqyrtuar 123 kërkesa dhe 29 ankesa nga personat fizik dhe juridik


3.3. Monitorimi i kuvendeve të komunave

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal konform mandatit ligjor të përcaktuar me legjislacionin për vetëqeverisje lokale monitoron komunat mbi bazën e të cilave harton raporte periodike për funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës. Komunat, përkatësisht organet e komunës janë të obliguara që ushtrimin e kompetencave të tyre ta zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore të Republikës së Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe kanë funksionuar Kuvendet e 38 komunave, bazuar në nenin 86 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. MAPL është e obliguar të hartojë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend të Republikës së Kosovës, *Raportin vjetor të funksionimit të komunave*. Ky raport është dërguar në Qeveri, Presidencë dhe Kuvend në fund të muajit Mars 2024. Janë hartuar 4 raporte për vlerësim të ligjshmërisë së akteve të komunave për periudhën

Janar-Dhjetor 2024, 2 raporte për vlerësim të Ligjshmërisë së akteve të komunave nga MAPL dhe Ministrinë e Linjës, raporti periodik i funksionimit të Komunave për periudhën Janar-Dhjetor 2023, si dhe janë mbajtur 3 takime me kryesuesit e kuvendeve të komunave dhe drejtorët komunal.

Në periudhën Janar – Dhjetor 2024, kanë funksionuar kuvendet në 38 komuna të Republikës së Kosovë, duke mbajtur mbledhje rregullisht. Kuvendet e komunave kanë mbajtur 541 mbledhje. Mbledhjet e kuvendeve të komunave janë monitoruar përmes sistemit të teleprezencës, si dhe prezencës fizike të zyrtarëve për komunal: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zvečan dhe Leposaviq. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsej 1948 akte, prej tyre 51 rregullore dhe 1897 vendime të kuvendeve të komunave.



Diagrami 1: Numri i mbledhjeve të komunave dhe aktet të pranuar gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024.

3.4. Adresimi i obligimeve nga agjenda evropiane

Roli i komunave në përmbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane është jashtëzakonisht i rëndësishëm në këtë proces. Një numër i lartë i prioritetëve të MSA-së janë nën përgjegjësinë dhe kompetencat e nivelit komunal, për çka Komisioni Evropian çdo vit i kushton rëndësi të veçantë theksimit të arriturve dhe sfidave të komunave në raportin e KE-së për vendin. Lidhur me këtë proces Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka bërë koordinimin e aktiviteteve me komuna për adresimin dhe zbatimin e obligimeve të cilat burojnë nga agjenda e integritetit evropian. Në këtë periudhë kohore është hartuar Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Qershor 2024. Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar - Qershor 2024 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin përafërsisht 52% të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kriterëve Politike, përafërsisht 36 % të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kriterëve ekonomike, si dhe përafërsisht 69% aktiviteteve të planifikuara në fushën e standardeve evropiane. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për periudhën Janar - Qershor 2024 është 53%.

Për të realizuar aktivitetet e agjendës evropiane, janë mbajtur takime me misionin e OSBE-së në Kosovë dhe në bashkëpunim me OSBE është mbajtur këshillimi i përbashkët dy ditorë me Zyrtarët Komunal për Integritet Evropiane, me qëllim të hartimit të planit gjithëpërfshirës të komunave për obligimet e agjendës evropiane për


vitin 2024, i njëjti plan është përditësuar me komentet e pjesëmarrësve si dhe me obligimet e komunave dhe MAPL-së që burojnë nga PKZMSA.

Gjatë kësaj periudhe raportuese është përgatitur Raporti i masave të MAPL-së mbi Zbatimin e Programit Kombëtar të Integritimeve Evropiane për vitin 2024. Gjithashtu, janë identifikuar dhe propozuar Obligimet e komunave dhe MAPL-së nga PKZMSA, dhe është përgatitur Inputi i MAPL-së për raportin e KE-së për Kosovën – 2024, për periudhën 15 qershor 2023 – 15 prill 2024 dhe për periudhën 15 prill – 31 gusht 2024.

Gjatë kësaj periudhe është dërguar kërkesa në komuna për raportimin e përmbushjes së agjendës evropiane për periudhën Janar-Dhjetor 2024 dhe është në proces hartimi i raportit të përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për periudhën Janar-Qershor 2024.

3.5. Koordinimi i politikave

Gjatë kësaj periudhe i është kushtuar shumë rëndësi zhvillimit të politikave të planit të punës së MAPL-së dhe Programit Kombëtar për Zhvillim. Për implementimin e duhur të këtyre politikave në vazhdimësi janë zhvilluar takime me departamente dhe njësitë organizative të MAPL-së për koordinimin e aktiviteteve të me ç' rast është përfunduar hartimi i planit vjetor të punës së MAPL-së për vitin 2025. Është përgatitur raporti për periudhën Janar-Dhjetor 2024 lidhur me zbatimin e aktiviteteve të MAPL-së në kuadër të Programit Kombëtar për Zhvillim 2024-2026. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë hartuar edhe dokumente të tjera, si:



IV. Ngritja e transparencës komunale, promovimi i të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i kapaciteteve

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe (Janar – Dhjetor, 2024) janë ato të cilat ndërlidhen me:

- Monitorimin e fushës së të drejtave të njeriut në komuna;
- Informimi i publikut rreth aktiviteteve të MAPL-së;
- Transparenca dhe llogaridhënia;

- Ngritja e kapaciteteve komunale; dhe
- Bashkëpunimit me shoqërinë civile.

4.1. Aktivitetet në fushën e të drejtave të njeriut dhe transparencën komunale

MAPL ka vazhduar me mbështetjen e komunave në zbatimin e politikave në fushën e të drejtave të njeriut. Në këtë periudhë është hartuar pyetësori për të drejtat e njeriut në komuna, pyetësori është bazuar në 10 fusha si: *funksionimi i njësive për të drejtat e njeriut, barazia gjinore, dhuna në familje, të drejtat e fëmijës, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, funksionimi i ZKKK-ve, si dhe të drejtat për gjuhë dhe përdorimi i gjuhës zyrtare*. Poashtu gjatë periudhës Qershor - Dhjetor në bashkëpunim me UN-Women është hartuar pyetësori për barazi gjinore. Në kuadër të përfaqësimit gjinor është hartuar raporti lidhur me numrin e grave në vendimmarrje.

Janë hartuar raportet si: raporti vjetor i vitit 2023 për të drejtat e njeriut, raporti për Monitorimin e Treguesve për Mbrojtje nga Diskriminimi, raporti rreth numrit të komunave për hapjen e fushatës në parandalimin e trafikimit me njerëz, raporti me të dhëna lidhur me numrin e grave në vendimmarrje, numri i grave të cilat kanë përfutur nga subvencionet, numri i regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve, raporti nga aktivitetet në identifikimin e problemeve të qasjes/barrierave në 5 komuna (Pejë, Gjiilan, Mitrovica e Jugut, Gjakovë dhe Mamushë), si dhe raporti për përdorimin e gjuhëve zyrtare 2023.

Në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për persona me aftësi të kufizuara, është hartuar raporti me të dhëna rreth numrit të punësuarve të personave me aftësi të kufizuara të punësuar në komuna, numrit të komunave të cilat kanë hartuar Planin e Veprimit për PAK, si dhe numri të komunave të cilat kanë caktuar interpreterin e gjuhës së shenjave. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se me përpjekjen e MAPL dhe Shoqatën e të Shurdhëve të Kosovës, në Komunën e Suharekës është caktuar interpreteri i gjuhës së shenjave.

Gjatë kësaj periudhe MAPL ka dërguar shkresën informuese tek të gjitha komunat e Republikës së Kosovës për t'i informuar rreth fillimit të fushatës për regjistrim falas të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ku edhe është hartuar raporti për numrin e të regjistruarve të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Gjithashtu në kuadër të programit ROMACTED II, janë organizuar dy punëtori me përfaqësuesit e dhjetë komunave partnere: *Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Graçanicë, Istog, Kamenicë, Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Obiliq dhe Prizren*, duke përfshirë edhe komunat tjera si: Gjiilan dhe Ferizaj. Qëllimi i punëtorive ishte mbledhja e të dhënave në lidhje me nevojat e komuniteteve dhe identifikimin e individëve të paregjistruar.

Sa i përket Barazisë Gjinore, në vitin 2024, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka luajtur një rol kyç në promovimin e barazisë gjinore në nivel lokal, në përputhje me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024.

MAPL në bashkëpunim me UN-Women ka mbështetur komunat në integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha programet lokale dhe në forcimin e kapaciteteve të administratës për të përmbushur kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për zbatimin e plotë të kërkesave për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor është mbajtur punëtorja 3 ditore me zyrtarët komunal duke përfshirë zyrtarët për Barazi Gjinore dhe drejtorët komunal të financave. Poashtu 16 komuna (Gjakovë, Pejë, Prizren, Prishtinë, Podujevë, Ferizaj, Gjiilan, Mitrovicë e Jugut, Lipjan, Hani i Elezit, Viti, Klinë, Kamenicë, Dragash, Graçanicë dhe Suharekë) kanë nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit me UN-Women për avancimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe barazisë gjinore në nivel lokal, si dhe 15 komuna kanë hartuar dhe miratuar Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore për periudhën 2024-2026.

MAPL, në bashkëpunim me institucionet relevante, ka punuar për të integruar këto standarde në nivel lokal, duke përfshirë edhe përmirësimin plotësim-ndryshimin e indikatorëve për matjen e progresit në barazinë gjinore.

Me mbështetjen e Projektit “Gender Equality Facility” të UN-Women Kosovë, është mbajtur punëtorja tre ditore përmes së cilës është bërë shkëmbimi i praktikave më të mira në zbatimin e kartës evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën lokale ndërmjet institucioneve lokale të Kosovës dhe Shqipërisë.

Gjithashtu në bashkëpunim me Organizatën “Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve”, “Terre des hommes” dhe “HEKS” është organizuar tryezë tre ditore, lidhur me ”Vlerësimin e kapaciteteve të strukturave komunale të mandatuara për të punuar me grupet e marginalizuara dhe “Rregulloren e (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil”.

Një tjetër punëtori në bashkëpunim me ZQM/ZKM dhe në mbështetje nga OSBE është organizuar lidhur me “Zbatimin e politikave për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, me pjesëmarrjeje të 22 komunave: Prizren, Rahovec, Suharekë, Mamushë, Pejë, Istog, Gjakovë Deçan, Klinë Kamenicë, Ferizaj, Gjilan Shtime, Novobërdë, Lipjan, Prishtinë, Fushë Kosovë, Graçanicë, Obiliq, Podujevë, Vushtrri dhe Mitrovica e Jugut.

Ndërsa sa i përket fushës së drejtave të fëmijës, MAPL në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe në mbështetje të OJQ Syri i Vizionit dhe UNICEF, ka arritur përmbushjen e obligimeve ligjore sa i përket Ligjit për Mbrojtje të Fëmijës. Me qëllim të zbatimit të *Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 06/2022 për Themelimin dhe Funksionimin e Ekspertit për të Drejtat e Fëmijës*, MAPL në bashkëpunim me ZQM dhe OJQ Syri i Vizionit në vazhdimësi ka mbështetur komunat në themelimin e Ekipeve për të drejtat e fëmijës, me ç’ rast në kuadër të projektit “*Detyrimi ynë për të Ardhmen – Mbrojtja e Fëmijëve dhe Qeverisja e të Drejtave të Fëmijës*”, ka organizuar punëtorinë për mbështetje në hartimin e Planit të Punës së Ekipeve të Fëmijëve në Komunat e Republikës së Kosovës duke siguruar që këto plane të jenë në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare përmes vizitave në komuna, ndihmës teknike si dhe fushatës së ndërgjegjësimit. Poashtu, në bashkëpunim me ZQM, Syri i Vizionit dhe UNICEF ka mbështetur komunat në hartimin e Planit të Veprimit, si dhe në bashkëpunim me ZQM, Syri i Vizionit dhe Save the Children kanë hartuar kornizën monitoruese për Ekipeve të Drejtave të Fëmijës në Komuna të Kosovës, i cili është prezantuar pranë *Kryesuesit dhe Sekretariatit* të Ekipeve për të Drejtat e Fëmijës në Komuna në dy sesionet informuese, të mbështetur nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar - SIDA.

Me qëllim të rritjes së vetëdijes për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, MAPL në vazhdimësi ka mbështetur komunat në realizimin e aktiviteteve të ndryshme ndërgjegjësuere në kuadër të *Fushatës Kundër Trafikimit me Njerëz*, duke u fokusuar në masat parandaluese që të rinjtë duhet të ndërmarrin për të mos rënë pre e trafikantëve.

MAPL, poashtu në vazhdimësi bën monitorimin e zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare dhe Gjuhëve në Përdorim Zyrtar në komunat e Republikës së Kosovës.

Ndërsa në kuadër të transparencës komunale, është hartuar raporti për transparencë të komunave për periudhën Janar- Dhjetor 2023 duke i monitoruar të dhënat përmes ueb faqeve zyrtare të komunave dhe për prezantimin e këtij raporti është mbajtur një takim me zyrtarët e informimit në komuna. Ndërsa në mënyrë të rregullt është vazhduar me vlerësimin e transparencës komunale, përfshirë monitorimin e kuvendeve të komunave në aspektin e transparencës, monitorimin e ekzekutivit dhe llogaridhënia në aspektin e transparencës, monitorimin e transparencës buxhetore të komunave, dhe transparenca në prokurimin publik, monitorimi i takimeve publike me qytetarët dhe zbatimi i standardeve minimale të konsultimeve publike.

MAPL në bashkëpunim me USAID ka realizuar aktivitete të ndryshme rreth monitorimit të zbatimit të *Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur*, me ç’ rast ka realizuar 7 takime me zyrtarë përgjegjës të komunave lidhur me *hartimin e Manualit për Buxhetim me Pjesëmarrje*, i cili rrjedhë nga ky udhëzim. MAPL, në vazhdimësi ka ofruar këshilla ligjore për hartimin e akteve dhe dokumenteve të ndryshme lidhur me transparencën komunale.

Gjithashtu janë realizuar takime me zyrtarët komunal ku është prezantuar raporti mbi vlerësimin e transparencës në komuna për vitin 2023, dhe Manuali për buxhetim me pjesëmarrje si obligim ligjor nga Udhëzimi Administrativ Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna.

Me mbështetje të OSBE-së MAPL ka organizuar takime me zyrtarë përgjegjës të komunave për hartimin e Model Rregullores për transparencë dhe Model Planit të Veprimit të transparencës në komuna. Ndërsa në shtator të vitit 2024 është hartuar Pyetësori për Zbatimin e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur, i cili është dërguar te komuna.

4.3. Zhvillimi i platformës shtetërore E-KOMUNAT

Platforma *E-Komunat* do të jetë në shërbim të qytetarëve për të rritur pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje në nivelin lokal, dhe do të jetë në shërbim të vet komunave për digjitalizimin e shërbimeve komunale. Në kuadër të kësaj MAPL si udhëheqëse e këtij procesi ka zhvilluar fazën e parë të platformës E-Komunat dhe pas lansimit të fazës së parë të platformës E-KOMUNA, MAPL ka vazhduar me zhvillimin e fazës së dytë të kësaj platforme e cila është në zhvillim e sipër.

Në kuadër të kësaj platforme, janë testuar dhe përzgjedhur 3 komuna pilot komuna (*Mitrovicë Jugore, Gjilan, Prishtinë*). Më 17 maj 2024 është mbajtur ceremonia e lansimit të platformës e-komunat, përkatësisht integrimit të 6 shërbimeve elektronike të platformës E-komuna në kuadër të platformës E-Kosova, si në vijim:

- Transmetimet direkte të mbledhjeve të asambleve komunale;
- Raporto problemet në komunën tuaj;
- Komunikim me zyrtarin komunal;
- Inicio dhe kontribuo në debatet publike për komunën tuaj;
- Informacione mbi komunat;
- Pasuria e zyrtarëve komunal.

Këto shërbime do të jenë të qasshme përmes platformës shtetërore E-KOSOVA me qëllim të lehtësimit të qasjes për të gjithë qytetarët. Gjithashtu në kuadër të funksionalizimit të platformës E-komunat – faza 2, kanë përfunduar dhe është në proces të shqyrtimit kërkesa për integrim të tri shërbimeve të tjera, si në vijim:

- Zhvillimi i modulit të mbledhjes së tatimeve komunale;
- Zhvillimi i modulit të investimeve kapitale;
- Zhvillimi i modulit për publikim të listës së pronave të paluajtshme të Komunës, sipas legjislacionit përkatës për dhënie në shfrytëzim të pronës së Komunës.

Pas trajnimeve të zyrtarëve komunal, platforma do të vihet për përdorim në 38 komunat e Republikës së Kosovës.

4.4. Informimi i publikut për aktivitetet e MAPL-së



Gjatë kësaj periudhe janë ofruar informata të vazhdueshme për publikun, mediat, shoqërinë civile, organizatat e huaja ndërkombëtare, si dhe palët e interesuara lidhur me aktivitetet e zhvilluara. Janë pranuar 22 kërkesa për Qasje në Dokumente Publike për të cilat janë kthyer përgjigje, 67 pyetje nga mediat dhe janë kthyer 67 përgjigje.

Në Ueb-faqen e MAPL-së gjatë kësaj periudhe janë publikuar si vijon: Në linkun Publikime janë publikuar 47 dokumente të shpenzimeve javore të kabinetit të Ministrit; në linkun vende të lira të punës janë publikuar 78 njoftime në gjuhën shqipe dhe serbe; në linkun lajme

janë publikuar 5 informata në tri gjuhët (shqipe, serbe dhe angleze); në linkun aktivitetet ditore janë publikuar 4 informata në tri gjuhët (shqipe, serbe dhe angleze); në linkun thirrje për propozime janë publikuar 34 dokumente në gjuhën shqipe; në linkun planet vjetore të MAPL-së janë publikuar dy (2) plane vjetore; në linkun shqyrtimi i ligjshmërisë – janë publikuar 502 dokumente në gjuhën shqipe dhe serbe; në linkun raportet vjetore të MAPL-së janë publikuar 13 dokumente në tri gjuhët (shqipe, serbe dhe angleze); në linkun Performanca Komunale janë publikuar 61 dokumente në tri gjuhët (shqipe, serbe dhe angleze); në linkun Rregulloret është publikuar 1 dokument në tri gjuhët (shqipe, serbe dhe angleze); Në rrjetin social - Faqen zyrtare të MAPL-së - facebook janë publikuar 11 informata.

Janë përgatitur 240 raporte ditore të pasqyrimin të mediave online, 24 raporte javore të kalendarit javor të aktiviteteve të Ministrit në raport me mediat, është përgatitur Raporti (Janar – Dhjetor 2024) lidhur me pyetjet e pranuar nga mediat, përgjigjet e kthyer nga MAPL-ja, kërkesat për Qasje në Dokumentet Publike si dhe Konferencat e mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe është raportuar në Zyrën për Komunikim Publik në Zyrën e Kryeministrit;

Gjithashtu në këtë periudhë janë dërguar 4 ftesa dhe 2 njoftime tek Kryetarët e komunave lidhur me takimet e rregullta me Kryeministrin e Republikës së Kosovës; 8 ftesa, 6 njoftime si dhe 1 komunikatë për media lidhur me aktivitetet e MAPL-së;

Në kuadër të planit të punës së DKP-së, MAPL në bashkëpunim me DEMOS kanë realizuar një trajnim dy ditor me zyrtarët për komunikim publik të komunave me temën: Komunikimi dhe Promovimi i performancës komunale si dhe përdorimi inteligjencës artificiale.

4.6. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka vazhduar me përfshirjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit për vetëqeverisje lokale dhe në implementimin e strategjisë për vetëqeverisje lokale 2016-2026, ku gjatë kësaj periudhe në çdo grup themelues për hartimin e politikave dhe legjislacionin e ministrisë është përfshirë edhe nga një anëtarë i shoqërisë civile.

4.7. Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal

Në pajtim me objektivat e strategjisë për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht forcimit të kapaciteteve institucionale të komunave, janë ndërmarrë veprime për zbatimin e aktiviteteve të parapara në këtë fushë. Në këtë drejtim, janë organizuar takime me IKAP dhe donatorë për të koordinuar aktivitetet rreth organizimit të trajnimeve për komuna konform planit të trajnimeve dhe për të ofruar përkrahje në realizimin e planit të trajnimeve dhe vlerësimin e nevojave për trajnime. Në bashkëpunim me DEMOS janë realizuar trajnime për koordinatorët e performancës komunale me temën *"Raportimi i të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) për vitin 2023 sipas Sistemit të rishikuar, janë realizuar edhe trajnime për zyrtarët raportues në komuna, poashtu është realizuar një trajnim me zyrtarët e informimit me temën "Komunikimi i performancës komunale", si dhe një trajnim me temën "Storjet e suksesit në promovimin e performancës komunale". Projekti DEMOS poashtu ka përkrahur edhe një trajnim për stafin e MAPL-së me temën "Zbatimi i Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK-së) si dhe Grantit të Performancës"*

MAPL në bashkëpunim me Organizatën "Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve", "Terre des hommes" dhe "HEKS" ka mbajtur një tryezë diskutimi rreth *"Vlerësimit të kapaciteteve të strukturave komunale të mandatuar për të punuar me grupet e marginalizuara. Poashtu janë mbajtur 2 sesione me temën "Korniza monitoruese të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës në komunë"*

Përkrahur nga Bashkimi Evropian është realizuar trajnimi *"Barazja Gjinore"* ku zyrtarët nga komunat forcan aftësitë dhe kapacitetet për t'u angazhuar në mënyrë efektive në qeverisjen me përgjegjësi gjinore dhe anëtarësimin në BE.

Gjithsej janë realizuar 16 sesione trajnimesh, përfitues kanë qenë 319 zyrtar komunal.

Planifikimi i qëndrueshëm i trajnimeve dhe programeve për zhvillim të kapaciteteve

V. Administrata, financat, auditimi dhe prokurimi

5.1. Administrata dhe financat



Për hartimin e planit të rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2024, është bërë mbledhja e informatave lidhur me kohën e paraparë për zotimin dhe shpenzimin e mjeteve, ky plan është dorëzuar në Ministrinë e Financave përmes sistemit të SIMFK-së.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është përcjell rrjedha e alokimit të mjeteve dhe janë bërë ndryshime për planin e shpenzimeve. Sa i përket raportit vjetor financiar për vitin e përfunduar 2023, është dorëzuar në MFPT dhe gjithashtu janë kryer të gjitha regjistrimet e pasurisë dhe stoqeve. Për sigurimin e kodeve për projektet kapitale, janë përgatitur dhe dorëzuar kërkesat dhe fletë alokimi për MFPT, janë kompletuar lëndët me MeM dhe PIP dhe janë alokuar mjetet për projektet e reja. Është përgatitur dhe dorëzuar Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2025-2027. Sa i përket kërkesave buxhetore për vitin 2025, pas pranimit të Qarkores buxhetore për vitet 2025-2027 janë identifikuar nevojat buxhetore dhe është dorëzuar kërkesa buxhetore. Është përgatitur hartimi i Programit të Investimeve Publike (PIP) në bazë të qarkores së

parë buxhetore, janë përgatitur dhe janë vendosur në sistemin BDMS shpenzimet në bazë të qarkores së parë buxhetore.

Gjatë kësaj periudhe është përgatit: 1) Raporti për listën e rrezeve për vitin 2023 dhe 2024 2) Raporti i listës së vetëvlerësimit për vitin 2023.

Për zotime, pranim të mallit, shpenzim dhe certifikim të lëndëve për pagesa janë pranuar kërkesat inicuese për zotimin e mjeteve në SIMFK, janë pranuar lëndët dhe faturat për procedim të pagesave dhe janë evidentuar në librin e protokollit, është bërë përgatitja CPO-së dhe është kryer regjistrimi i zotimeve, shpenzimeve dhe certifikimi në SIMFK, është kryer pranimi i mallit në SIMFK dhe evidentimi në librin e protokollit intern, është bërë skanimi i lëndëve, arkivimi elektronik në Share Folder si dhe arkivimi fizik i lëndëve.

Gjatë kësaj periudhe është bërë raportimi, barazimi i raportit të SIMFK dhe analizimi i tij me raportet e shpenzimeve për periudhën Janar - Dhjetor 2023 dhe në baza mujore për periudhën janar - dhjetor 2024. Ndërsa sa i përket objektivit *Paraja e imët (Petty Cash)* dhe *Avanse për udhëtime zyrtare*, është bërë hapja e petty cashit për administratë dhe për kabinet, është bërë përgatitja e fletëpranimit standard të parasë së imtë dhe vendosja e të dhënave në çarshaf për kërkesat e bërë për Petty Cash, është bërë përgatitja e formularëve dhe llogaritja e shpenzimeve para dhe pas kthimit të zyrtarëve nga vizita zyrtare, është bërë tërheqja e parave të gatshme nga banka komerciale dhe kthimi i mjeteve në rastet kur ka pasur kthim të mjeteve dhe është bërë mbyllja e Kredit Karteleve në rastet kur ka pasur shpenzime.

Për raportimin e obligimeve të papaguara dhe obligimeve kontraktuale në vazhdimësi janë përgatitur dhe dorëzuar raportet mujore për faturat e papaguara dhe obligimeve kontraktuale. Ndërsa për hartimin e raporteve mujore financiare dhe raporteve tjera mbi shpenzimet e përgjithshme, janë përgatitur raportet javore për buxhetin e përgjithshëm për MAPL-në zotimi, shpenzimi dhe certifikimi. Janë hartuar raportet e kontabilitetit mbi shpenzimet e përgjithshme, janë dorëzuar raportet javore të buxhetit dhe në vazhdimësi janë kontrolluar lëvizjet buxhetore. Për menaxhimin e pasurisë së MAPL-së gjatë kësaj periudhe është kryer: regjistrimi i pasurisë mbi 1,000.00 € në SIMFK, regjistrimi i pasurisë në sistemin e-pasuria dhe bartja e investimeve kapitale në komuna pas përfundimit të projekteve.

Është përgatitur dhe dorëzuar Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit Gjeneral, si dhe plani i veprimit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike sipas vendimit të Qeverisë.

Buxheti i MAPL-së për vitin 2024, (bazuar në raport të datës 09.01.2025 për vitin 2024) së bashku me Donacionin (93 Council of Europe dhe WB-Banka Botërore) është 16,425,121.16 €. Nga kjo shumë për periudhën Janar – Dhjetor nga buxheti i konsoliduar i Kosovës janë shpenzuar 13,229,099.77 € ose 89.38 % e buxhetit. Prej kategorisë së donacionit 93 Council of Europe është shpenzuar shuma 180,973.91 € ose 67.74 % e buxhetit, ndërsa nga donacioni WB-Banka Botërore është shpenzuar shuma 935,058.26€ ose 68.23 %.

Në total Buxheti i MAPL-së + Donacionet (93 Council of Europe dhe WB-Banka Botërore) për periudhën Janar-Dhjetor 2024 është shpenzuar në vlerë prej: 14,345,158.94 € ose 87.34 % e buxhetit.

MAPL për periudhën Janar-Dhjetor 2024 ka iniciuar 23 kërkesa për rekrutimin sipas procedurave të rekrutimit, e njëjta kërkesë është aprovuar dhe është publikuar në sistem. Janë pranuar kërkesa për praktikë dhe për të njëjtat janë nënshkruar marrëveshjet si dhe është bërë regjistrimi elektronik i studentëve të cilët kanë kryer praktikën në këtë periudhë. Janë identifikuar nevojat për trajnime dhe është përgatitur plani i trajnimeve. Sa i përket fushës së trajnimeve të stafit janë pranuar 6 kërkesë nga IKAP për trajnime. Janë përgatitur raportet mujore të vijueshmërisë për stafin, janë proceduar 15 ID kartela të reja, janë aprovuar gjithsejtë 150 kërkesa për ndryshime në listën e pagave (ndryshimet e bëra janë dërguar në MF).

Për këtë periudhë raportuese sipas njoftimit të pranuar nga Agjensioni Kundër Korrupsioni janë përditësuar të dhënat në sistem lidhur me deklarinimin e pasurisë.

5.2. Auditimi i Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) ka përmbyllur punën e vitit 2023 duke hartuar raportin e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2023 dhe raportit vjetor të punës së NJAB për vitin 2023 i cili është proceduar tek menaxhmenti i lartë i MAPL-së dhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm (NJQH-AB). Poashtu është mbajtur takimi i I-rë me Komitetin e Auditimit dhe Menaxhmentin e lartë të MAPL-së.

Gjatë kësaj periudhe janë finalizuar raportet si në vijim:

- Sistemi i menaxhimit të pasurisë në MAPL;
- Menaxhimi i burimeve njerëzore në MAPL;
- Sistemi i menaxhimit të prokurimit në MAPL;
- Sistemi i menaxhimit të buxhetit në MAPL;
- Menaxhimi i investimeve kapitale në MAPL.

Është përgatitur *Raporti i gjashtëmujorit të parë i punës së NJAB dhe Plani Strategjik 2025-2027 dhe Plani Vjetor i NJAB për vitin 2025*, dhe pas aprovimit nga ana e Udhëheqësit të Subjektit të Sektorit Publik/Ministrit është dorëzuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), konkretisht në Njësinë Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm (NJQHAB).

5.3. Prokurimi

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024, janë grumbulluar kërkesat për mallra, shërbime dhe kapitale nga Njësitw dhe Departamentet e MAPL-së, pas grumbullimit të kërkesave është përfunduar planifikimi për vitin fiskal. Plani i prokurimit është përfunduar dhe proceduar tek Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së dhe është lansuar në platformën elektronike KRPP-AQP. Në kuadër të planit të prokurimit, janë zhvilluar aktivitetet në kuadër të kontratave të planifikuara: *kontrata për furnizim, kontrata për shërbime dhe kontrata për kapitale*.

Në përputhje me kërkesat e Departamenteve janë realizuar artikujt si: Furnizim me material shpenzues, Furnizim për zyre Aparat për ujë, Furnizim me IT (PC, Monitor dhe Laptop), Furnizim me inventar për zyre, Furnizim me pajisje tjera të IT –së, Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve të veturave, Pastrimi i veturave zyrtare të MAPL-së dhe Kontrollimi teknik. Kurse për furnizime të tjera nuk ka pasur kërkesa inicuese. Gjithashtu në këtë periudhe është hartuar Raporti i kontratave të nënshkruara për vitin 2023.